

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

HULUMTIMI

NDIKIMET E TRAJNIMEVE NË PROCESIN MËSIMOR

RAPORT PËRFUNDIMTAR

PRISHTINË, Shtator 2008

BARTËSIT DHE EKIPI HULUMTUES

EKIPI HULUMTUES:

Agron Mexhuani

Gani Gajraku

Sylejman Sylejmani

Binak Gërguri

Arbnesha Mexhuani

Skënder Mekolli

Autorë të projektit:

Gani Gajraku

Agron Mexhuani

EMRI I HULUMTIMIT: *NDIKIMET E TRAJNIMEVE NË PROCESIN MËSIMOR*

LLOJI: *INICIATIVË HULUMTUESE E SEKTORIT TË PLANIFIKIMIT MËSIMOR-*

NJËSIA E AFTËSIMIT TË MËSIMDHËNËSVE

FINANCUES: *INSTITUTI PEDAGOGJIKI I KOSOVËS*

MBYKQYRËS: *INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS*

ZBATUES: *IPK*

KOHËZGJATJA : *MARS-KORRIK, 2008*

LOKACIONI : *REPUBLIKA E KOSOVËS*

KOMUNA TË PËRFSHIRA NË HULUMTIM: *7(SHTATË)*

GRUPI I SYNUAR : *SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME TË ULËTA*

SHKOLLA TË ANKETUARA : *16 (GJASHTËMBËDHJETË)*

INSTRUMENTI HULUMTUES: *TESTET (PYETËSORË)*

NUMRI I PYETËSORËVE : *613*

PYETËSORË VALIDË: *613 /JO VALID:0*

HYRJE

Pas vitit 1999, Kosova, si nënshkruese e marrëveshjes së Procesit të Bolonjës, i ka hyrë reformave arsimore nga niveli Parashkollor e gjerë te ai Universitar, duke përfshirë edhe hartimin e kurrikulave. Hartimi i kurrikulave paraqiti nevojën e hartimit të plan-programeve të reja, teksteve shkollore dhe aftësimin profesional të mësimit, në mënyrë që t'i bashkëngjitet arsimimit bashkëkohor në familjen evropiane, në mënyrë që të njihet çertifikimi kosovar nga bashkësia ndërkombëtare.

Para disa vitesh, në vendet e Evropës Perendimore, ka lindur një prirje, procesi i quajtur „Universitarizmi i Përgatitjes së Mësuesve”. Sot, po thuaj të gjitha këto vende e kanë ngritur në nivel universitar përgatitjen e mësimit duke e reformuar tërësisht këtë sistem. Shkolla sot është një institucion ku nuk kërkohet më riprodhimi apo zotërimi i informacionit, por ajo ka për mision të përgatitë gjeneratat e reja për të kërkuar informacionin, operuar dhe analizuar në mënyrë kritike dhe për të aftësuar nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin probleme në mënyrë kritike.

Në Kosovë, gjatë kësaj periudhe kohore, shumë organizata qeveritare dhe joqeveritare kanë ofruar programe të ndryshme në aftësimin profesional të shoqërisë kosovare, ndër të tjera edhe aftësimin e mësimit me metodologjitë e reja të mësimit dhe mësimit.

Bazuar në këtë, ky hulumtim është fokusuar në atë se sa dhe si kanë ndikuar trajnimet tek mësimit në procesin mësimor, duke patur parasysh numrin e madh të mësimit të trajnuar. Për t'i vërejtur ndikimet e këtyre trajnimeve në procesin mësimor, është bërë hulumtimi dhe janë nxjerrur rezultatet të cilat janë paraqitur në vazhdim të këtij punimi.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Lënda e hulumtimit

Në shkollat tona një numër i madh i mësimitdhënësve janë trajnuar me programe të ndryshme të metodologjive të reja të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies, të cilat kanë patur për qëllim që mësimitdhënësi të mos jetë vetëm burim informacioni, por organizator dhe udhëheqës i mirë i procesit mësimitor, ndërsa nxënësi të jetë i përgatitur për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin. Si objekt hulumtimi kemi marrë atë se sa janë të trajnuar mësimitdhënësit me metodologjitë bashkëkohore, si dhe sa kanë ndikuar trajnimet në procesin mësimitor; në plan-programe, tekste mësimore, në vlerësim si dhe nevojat trajnuese.

Nevoja e hulumtimit

Ky hulumtim është i domosdoshëm për arsye se në të ardhmen do të kemi identifikimin e problemeve dhe vlerësimin e nevojave të trajnimit që është synim final për të ditur se çfarë trajnimi dhe zhvillimi duhet të kenë mësimitdhënësit. Gjithashtu, gjatë punës është planifikuar të hulumtojmë se cilat programe trajnuese kanë patur ndikim pozitiv në ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies dhe mësimitnxënies, sa dhe si janë duke u aplikuar programet trajnuese me qëllim që trajnimet për mësimitdhënës të patrajnuar të vazhdojnë në ato programe.

Caktimi i kufijëve

Hulumtimi është fokusuar vetëm në aspektin specifik të problemit. Qëllimi i hulumtimit është ndikimet e trajnimeve në procesin mësimitor, rezultatet e trajnimeve dhe zbatueshmëria e teknikave të reja të punës.

Supozimet

Rezultatet e këtij hulumtimi mund të jenë tregues të konsiderueshëm në opinion, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe nevojat që kërkohen në këtë proces. Nevoja për aftësim permanent është e madhe, prandaj ky hulumtim nxjerrë në pah nevojat dhe prioritetet e domosdoshme të mësimdhënësve për tu trajnuar.

QËLLIMI DHE DETYRAT E HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim ka për qëllim informimin se si kanë ndikuar metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies në procesin mësimor dhe përmes rezultateve të tij, ti nxjerrim rekomandimet e drejtuesve të shkollave, mësimdhënësve, nxënësve dhe të tjerëve për ti prezantuar në MASHT, në mënyrë që nevojat dhe kërkesat e tyre për ngritje të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies të realizohen në praktikë.

Detyrat e hulumtimit

Për të arritur qëllimin e hulumtimit kemi zgjedhur disa detyra:

- Të analizojmë dhe të studiojmë këtë problem;
- Të hartojmë anketën (pyetësorin), si mjet hulumtimi;
- Të informojmë udhëheqësit e shkollave;
- Të grumbullojmë të dhëna përmes pyetësorëve;
- Të bisedojmë me palët e interesit;

- T'i përpunojmë të dhënat e grumbulluara;
- T'i paraqesim në mënyrë grafike këto rezultate;
- Të nxjerrim rekomandime;
- T'i interpretojmë rezultatet e hulumtimit.

Definimi i problemit

Gjatë implementimit të reformave në arsim, janë paraqitur probleme të ndryshme. Këto probleme nuk janë asgjë tjetër vetëm synime për të arritur deri tek ajo se çfarë dëshirojmë. Mirëpo, për të arritur deri te përmirësimi i gjendjes në arsim, kemi hasur në vështërsi të mëdha për përdorimin e metodologjive të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies nga mësimdhënësit dhe vështërsitë e nxënësve për të përballur me këto metoda. Ka mësimdhënës që janë kundër këtyre reformave, sepse ata nuk janë në gjendje të ndryshojnë dhe për këtë arsye edhe reforma është keqkuptuar. Gjithashtu, kemi konstatuar se pengesa në këtë drejtim janë edhe ato teknike si: mungesa e hapësirës shkollore dhe e mjeteve mësimore. Nga kjo kemi konstatuar se të gjitha përparësitë dhe mangësitë janë të natyrave subjektive dhe objektive.

Ngritja e hipotezave

Kemi supozuar se trajnimet e mësimdhënësve për procesin mësimor ndikojnë pozitivisht në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Një numër i madh i mësimdhënësve nuk i zbatojnë këto teknika të reja në praktikë. Mospbatueshmëria e metodologjive të reja e kërkon nevojën urgjente të organizimit dhe përgatitjeve për monitorim të përhershëm të të gjitha strukturave në shkolla, nga njerëz kompetentë, në mënyrë që të përkrahet dhe përparohet puna

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

në shkolla. Mungesa e trajnimeve, keqkuptimi i reformës arsimore, pjesëmarrja e mësimdhënësve në trajnime vetëm për tu certifikuar, janë probleme që gjithashtu e kanë lindur nevojën për këtë hulumtim.

METODAT E HULUMTIMIT

Për të hulumtuar dhe studiuar këtë problem në mënyrë të gjithanshme kemi përdorur këto metoda të hulumtimit:

1. Metoda bashkëbiseduese
2. Metoda përshkruese
3. Metoda statistikore
4. Metoda krahasuese

Metoda e bisedës

Metoda e bisedës është një prej metodave që kemi përdorur gjatë hulumtimit me mësimdhënës, nxënës dhe drejtorë. Bashkëbisedimet janë bërë me qëllim që të hetojmë dallimet në mes të deklarimeve gojore dhe atyre në pyetësor, rreth zhvillimit të praktikave të kërkuara në lëndën e hulumtimit.

Metoda përshkruese

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

Me këtë metodë kemi përshkruar dukurinë që është objekt hulumtimi, po ashtu kemi përshkruar të dhënat që kanë të bëjnë me ndikimet e trajnimeve gjatë procesit mësimor, shkaktarët, pasojat, rezultatet, opinionet dhe rekomandimet.

Metoda statistikore

Metodën statistikore e kemi përdorur për të nxjerrur dhe krahasuar të dhënat e kërkuara me përqindje, përmes tabelarëve dhe grafikoneve. Me këtë metodë kemi hulumtuar, studiuar, analizuar dhe rekomanduar për ç'ështëjet e kërkuara dhe gjendjen në arsim përmes opinionëve të të anketuarëve. Nga kjo kemi paraqitur edhe rekomandimet për nevojat e përmirësimit të gjendjes në arsim.

Metoda krahasuese

Kjo metodë zë një vend të rëndësishëm ngase me këtë është bërë krahasimi i procesit mësimor që zhvillohet në zonat urbane dhe ato rurale . Janë përzgjedhur këto dy ambiente për të hulumtuar **shkallën e trajnimit** të mësimitdhënësve,**nivelin e informimit** të mësimitdhënësve për **reformën,punën** e mësimitdhënësve të pakualifikuar dhe të patrajnuar si dhe **zbatimin e programeve trajnuese** nga mësimitdhënësit e trajnuar në specifika të ndryshme.Bazuar në këtë shih:Rezultatet e hulumtimit.

Popullacioni dhe mostra

Popullacioni i këtij hulumtimi është i madh dhe numerikisht i caktuar. Grupi reprezentativ përbëhet prej 632 pjesëmarrësve si: mësimitdhënës,nxënës dhe drejtorë të shkollave. Janë anketuar 276 mësimitdhënës, 336 nxënës dhe 20 drejtorë. Mostra ka qenë grupore dhe individuale.

MJETET DHE TEKNIKAT E HULUMTIMIT

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

Grumbullimi i të dhënave në këtë hulumtim është bërë përmes pyetësorit si mjet kryesor për hulumtim. Pyetësi ka pasur nëntë pyetje për mësimdhënës, nëntë për nxënës dhe nëntë për drejtorë. Pyetjet kanë qenë të tipit të mbyllur dhe të hapur. Si teknikë kemi përdorur anketimin përmes të cilit kemi marrë të dhënat nga nxënësit, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave në Arsimin e Mesëm i Ulët dhe i Mesëm i Lartë. Pyetësit janë përkthyer edhe në gjuhën boshnjake për paralelet boshnjake në Dobrushë të Istogut dhe në Vitomiricë të Pejës.

ORGANIZIMI I HULUMTIMIT

Lënda e hulumtimit është përgatitur në fund të vitit të kaluar dhe në fillim të këtij viti, ndërsa planifikimi dhe realizimi i punës është bërë gjatë muajve: mars, prill, maj të këtij viti. Hulumtimin në shkolla e kemi realizuar brenda një ore ësimore. Nxënësit e kanë plotësuar pyetësin në praninë e hulumtuesve. Kjo ka ndodhur edhe me mësimdhënës. Për plotësimin e tyre u janë dhënë sqarime të nevojshme nxënësve, mësimdhënësve dhe drejtorëve. Bashkëbisedimi me palët e interesit është kryer gjatë kohës së lirë. Informacionet janë marrur kryesisht nga drejtuesit e shkollave. Hulumtimi është kryer në këto shkolla të këtyre komunave:


Gjilan: Shkolla fill. „Selami Hallaçi” mësimdhënës 9, nxënës 20, drejtori. Shkolla e Mesme Ekonomike „Marin Barleti”, mësimdhënës 12, nxënës 10. **Pejë:** Shkolla fill. „8 Marsi” mësimdhënës 21, nxënës 17, drejtori dhe Shkolla e Mesme e Mjekësisë, mësimdhënës 11, nxënës 23. Shkolla e mesme “Ali Hadri”, komuniteti boshnjak, mësimdhënës 12. **Vitomiricë:** Shkolla fill. „7 Shtatori” paralelja boshnjake, mësimdhënës 18, nxënës 18, drejtori, paralelja shqipe, ”7 Shtatori”, mësimdhënës 13, nxënës 18. **Istog:** Shkolla fill. „Fan S. Noli” mësimdhënës 10, nxënës 19, drejtori, paralelja boshnjake. **Ferizaj:** Shkolla fill. „Ahmet Hoxha”, mësimdhënës 18, nxënës 17, drejtori. Shkolla e Mesme e Mjekësisë „Elena Gjika”, mësimdhënës 13, nxënës 18, drejtori dhe Shkolla fill. „Jeta e Re” në **Greme:** mësimdhënës 16, nxënës 20. **Gjakovë:** Shkolla fill. „Yll Morina” mësimdhënës 16, nxënës 19, drejtori „Gjimnazi „Hajdar Dushi” mësimdhënës 14, nxënës 20 dhe Shkolla fill. „At Gjergj Fishta”, mësimdhënës 19, nxënës 20. **Malishevë:** Shkolla fill. „Naim Frashëri” mësimdhënës 20, nxënës 20. **Prizren:**

Shkolla e mesme e Mjekësisë "L. Maqtroni", mësimdhënës 15, nxënës 19. dhe Gjinnazi „Gjon Buzuku”, mësimdhënës 8, nxënës 20. **Mitrovicë:** Shkolla fill.” A. Z. Çajupi”, mësimdhënës 18, nxënës 18, drejtori. dhe Shkolla fill. „Hivzi Sulejmani” mësimdhënës 20, nxënës 20, drejtori.

Pasqyra grafike


Në këtë pasqyrë grafike janë paraqitur opinionet e përbashkëta të drejtorëve, mësimdhënësve dhe nxënësve.

1. A janë të përshtatshme tekstet mësimore me metodologjitë bashkëkohore?
Graf. 1



Sipas rezultateve të dhëna, 44 % janë shprehur se tekstet mësimore janë të përshtatshme me metodologjitë bashkëkohore, 24 % janë shprehur se nuk janë të përshtatshme, 9 % janë shprehur me disa, 20 % janë shprehur me pjesërisht dhe 1 % nuk janë deklaruar.


2. Sa kanë ndikuar trajnimet e mësimdhënësve në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies?
Graf 2.



Opinionet e të anketuarve janë: 54% pjesërisht, 41% shumë, 4% aspak dhe 1% nuk janë deklaruar.

3. Në shkollën tuaj përgatiten nxënës me njohuri:


Graf. 3



Në graf. 3, 63% janë të mendimit se përgatiten nxënës me **njohuri njohëse**, 21% me **njohuri hulumtuese**, 14% me **njohuri përshkruese** dhe 1% nuk kanë dhënë përgjigje.

4. Çfarë lloje të testeve për vlerësim hartohen në shkollën tuaj?


Graf. 4



Në këtë grafik, opinionet e të anketuarëve për: Çfarë testesh hartohen në shkollën tuaj? Përgjigjet janë dhënë; 5%, janë shprehur sipas T. Blumit, 15% me alternativa, 28%, me plotësime në vendet e zbrazëta, 41% të kombinuar dhe 11%, me Ese.

5. Vlerësimi bëhet duke u mbështetur në:

Graf. 5



Sipas rezultateve të të anketuarëve del se, 49%, e mësimit vlerësojnë, duke u mbështetur në **përmbajtje dhe shkathhtësi**, 47%, bazohen në **mendimin kritik kreativ** dhe 4% nuk janë prononcuar.


Krahasuar grafikun 4 me atë 5, është konstatuar se në këtë të fundit, të anketuarit janë përgjigjur pa analizuar punën e tyre praktike. Si arsyetim

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

shih graf4 në përgjigjen e parë theksohet se vetëm 5% hartojnë teste në bazë të T. së Blumit ndërsa në graf.5 del se 47% prej tyre vlerësojnë duke nxitur të menduarit kritik dhe kreativ.

6. Mësimdhënës të trajnuar sipas komunave në të cilat është kryer hulumtimi.

Graf.6



Në bazë të këtyre hulumtimeve në komunën e Gjiçanit 10 % janë të trajnuar dhe 3 % të patrajnuar. Ferizaj 16 %-5%. Gjakovë, 20 %,janë të trajnuar, 1 %,të patrajnuar. Malishevë, 6 %, janëtëtrajnuar,2%,janë të patrajnuar. Mitrovicë,10%,janë të trajnuar,4%,janë të patrajnuar. Prizren,10%,janë të trajnuar. Pejë,9%,janë të trajnuar. Istog,4%,janë të trajnuar. Këto të dhëna janë paraqitur,varësisht nga numri i të anketuarëve. Shih:Rezultatet e hulumtimit

Opinionet e mësimeve, nxënësve dhe udhëheqësve të shkollave

Shkolla e Mesme e Ulët "8 Marsi" Pejë

Opinionet e mësimeve

- Trajnimet e mësimeve duhet të jenë në vazhdimësi që të përfshihen të gjithë.
- Reforma është hap shumë i madh për arsimin në Kosovë pasi që dihet se në çfarë periudhe ka kaluar arsimi ynë.
- Të harmonizohen tekstet shkollore me plan- programet dhe metodologjitë e reja të mësimit dhe mësimnxënies.
- Tekstet e klasave të para të kenë më shumë ilustrime dhe të jenë tërheqëse për fëmijë.
- Të vazhdohen trajnimet me programin e MKLSH-së

Opinionet e nxënësve

- Të mbahen më shumë aktivitete në shkollë.
- Të mbahen më shumë teste.
- Disa mësime nuk i aplikojnë reformat.
- Të ndërtohen raportet mësime-nxënës.
- Të ngritet përgjegjësia e nxënësve.
- Arsimtarët të përgatiten për mësimdhënie.

Opinionet e drejtorit

- Të mbahen trajnime për mësime për MKLSH, MNQ dhe Psiko-social.

Shkolla e mesme e Mjekësisë Pejë

Opinionet e nxënësve

- Të zvogëlohet numri i lëndëve në kl. XIII, sepse është dallim i madh nga numri i lëndëve nga kl. XII, kur dihet se në kl. e XII, janë vetëm 9 lëndë mësimore e në të XIII, kemi 19 lëndë.

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

- Të ndërpriten ofendimet e mësimeve ndaj nxënësve
- Të mos ketë dallime gjatë vlerësimit ndaj nxënësve e sidomos ndaj gjinisë mashkullore.
- Në shkollat profesionale mungojnë tekstet shkollore e sidomos ato të lëndëve profesionale.
- Mësuesit, ende japin shënime si pasojë e mungesës së teksteve.
- Ende aplikohen vlerësime të nxënësve me dalje te tabela dhe e anketave p.sh. caktimi i tri temave.
- Të stimulohen mësuesit e mos t'i bartin problemet e tyre nga jashtë në procesin mësimor.

Opinionet e mësimeve

- Trajnerët të jenë nga lëndët profesionale.
- Trajtime për pjesën praktike të mësimin.
- Të mos mbahen trajtime vetëm teorike por edhe në aspektin praktik.
- Të verifikohen trajnerët ekzistues.
-

Opinionet e drejtorit

- Të trajnohen të gjithë mësuesit.

Shkollat” Hivzi Sylejmani” Këq i Madh

Opinionet e nxënësve

- Tekstet alternative sa janë të mira po aq janë edhe të dëmshme për nxënësit pasi që ato shpeshherë janë me përmbajtje të ndryshme.
- Mësuesit të mos i keqpërdorin reformat.
- Të formohen kabinete për punë praktike.
- Përgatitja profesionale e mësimeve të jetë në nivel të duhur.
- Të botohet libri i informatikës për nivelin e Shkollë të mesme e Ulët.
- Nxënësit të jenë të vetëdijshëm përse vijnë në shkollë.
- Mësuesit edhe pse të trajnuar nuk i zbatojnë metodologjitë e reja.
- Bashkëpunimi me prindër të jetë shumë më i madh.
- Prindërit të jenë të kujdesshëm dhe përgjegjës ndaj fëmijëve të tyre.

Opinionet e mësimeve

- Të mbahen trajnime për MKLSH
- Të mbahen trajnime të mësimeve për vlerësim
- Të gjithë mësuesit duhet të trajnohen.
-

Opinionet e drejtorit

- Pa u trajnuar të gjithë mësuesit, nuk arrihen reformat.

Shkolla e Mesme e Ulët "A.Z.Çajupi"-Mitrovicë

Opinionet e mësimeve

- Të zvogëlohet numri i nxënësve në klasa.
- Të mbahen trajnime për MKLSH, MNQ dhe Psiko-social
- Të mbahen trajnime për mësuesit klasor.
- Trajnime për vlerësim.
- Të mbahen trajnime për lëndët shkencore, sepse nxënësit po largohen nga ato
- Të mos reduktohen orët mësimore shumë p.sh. Matematikë kl. IX.
- Trajnime të jenë më konkrete.
- Trajnime për vlerësim dhe për hartimin e testeve.
- Trajnime nga njerëz profesionistë.

Opinionet e nxënësve

- Ta kemi një libër të përshtatshëm për përdorimin e kompjuterit.
- Hartat të jenë në librin e Gjeografisë.
- Të ketë më shumë fletore pune, në mënyrë që mësimi të jetë kreativ.
- Të ngritet përgjegjësia e nxënësve në shkollë.
- Të krijohen kushte për mbajtjen e mësimit praktik.
- Të kemi kyqje në internet dhe mësim plotësues.
- Të sensibilizohet bashkëpunimi me prindër. (**për tu theksuar**)

Opinionit i drejtorit

- Të vazhdohet me trajnime për MKLSH dhe MNQ

Gjimnazi “Hajdar Dushi”-Gjakovë

Opinionet e mësimehdhënësve

- Të krijohen kushte në shkolla për të zbatuar metodologjitë e reja.
- Të rishikohen dhe të reduktohen plan- programet mësimore.
- Të bëhen trajnime permanente e në veçanti trajnime lëndore.
- Të zvogëlohet numri i madh i nxënësve nëpër klasa.
- Të rishikohen tekstet mësimore. Objektivat të jenë të arritshme.
- Tekstet janë të stërngarkuara gjë që nuk arrihet të jetë ora e suksesshme për 40 min.
- Të përmirësohet infrastruktura dhe kushtet shkollore.
- Metodologjitë e reja nuk gjejnë zbatueshmëri nga ana e mësimehdhënësve.

Opinionet e nxënësve

- Të krijohen kushte për mësim praktik.
- Mësimehdhënësit të jenë më aktiv gjatë orës mësimore.
- Vlerësimi të bëhet me teste,por të ngriten kriteret e testit.
- Interesimi i nxënësve për mësim është në shkallë kritike, (të merren masa).
- Mungon puna praktike me nxënës.
- Testet të jenë me alternativa.
- Drejtori ti monitoroj orët mësimore.
- Të ndryshoj mënyra e vlerësimit.

Opinionit i drejtorit

- Trajnime për MKLSH dhe për mësim praktik.

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

Shkolla fill. "Selami Hallaçi"

Opinionet e mësimeve

- Të ndërmerren masa për zgjatjen e orës mësimore sepse ora me 30 min. nuk mund të jetë e suksesshme andaj si e tillë po ndikon tek nxënësit e sidomos në provimin e testit të arritshmërisë për kl. e IX-ta.
- Opinion dhe kërkesë e vetë nxënësve është që të ngritet përgjegjësia e nxënësve në shkolla.

Opinionet e nxënësve

- Të ngriten përgjegjësitë e nxënësve në shkollë.
- Të mbahen më shumë orë praktike.
- Të krijohen kushte për lënden e Informatikës.
- Të rregullohet ambienti shkollor.
- Të respektohet orari mësimor nga mësimeve.

Opinionet e drejtorit

- Fatkeqësisht, mungon institucioni profesional për monitorim të efektshmërisë së trajnimeve.

Shkolla e mesme ekonomike "Marin Barleti"

Opinionet e mësimeve

- Testi i arritshmërisë dhe ai i maturës të bazohen në tekstet shkollore.
- Testi i arritshmërisë dhe ai i maturës nuk janë të përshtatshëm për të vlerësuar arritjet e nxënësve për të ardhmen e tyre.
- Testi i arritshmërisë dhe ai i maturës nuk janë teste të vlerësimit real mbi njohuritë e nxënësve pasi që vetë testi në vetvete shkakton stres, andaj si i tillë ky lloj testi vlerëson më shumë gjendjen momentale-emocionale të nxënësit e jo aftësitë e tij 9 apo 12-13 vjeçare të shkollimit
- Në shkollën ekonomike mungojnë tekstet shkollore gjë që ndikon në mos zbatueshmërinë e metodologjive të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies
- Në këtë shkollë japin mësim, mësimeve të profesioneve tjera që nuk kanë fare të bëjnë me lëndët që i ligjërojnë .

Opinionet e nxënësve

- Të ketë më shumë bashkëpunim në mes të MASHT-it dhe shkollave, sepse Plan-programet po na shkaktojnë telashe në Testin kombëtar, ku pyetjet në test, dalin që nuk i kemi përpunuar.
- Të mos bëhet vlerësimi i nx. nga ndikimet e jashtme.
- Të debatohet në teren nga njerëz kompetentë për shumë çështje të arsimit.

Opinionet e drejtorit

- Të vazhdohet me trajnime në Metodikë-Didaktikë

Shkolla "7 Shtatori", paralelja shqipe

Opinionet e mësimitdhënësve

- Trajnerët e programeve të ndryshme të jenë të përgjegjshëm gjatë seminarit.
- Trajnimet do të kenë vlerë atëherë kur të krijohen kushtet e kurrsezi tani.
- Të mos favorizohen disa mësimitdhënës për pjesëmarrje në trajnime të ndryshme e të tjerët të mbeten fare pa u trajnuar.

Opinionet e nxënësve

- Të pajisen shkollat me kabinete dhe laboratorë në mënyrë që të kemi mësimnxënie të suksesshme.
- Të ndërpriten intervenimet dhe faktorët e jashtëm për vlerësimin e nxënësve.
- Zbatueshmëria jo e drejtë e metodologjive të reja shkakton dëme tek nxënësit pasi që shumë nxënës ngecin në marrjen e njohurive.
- Të krijohet atmosferë pune dhe të krijohet qetësi gjatë zhvillimit të orës mësimore.
- Të ndërmerren masa ndaj nxënësve që shkojnë rrugëve të gabuara dhe të parandalojnë devijimin e tyre, e njëkohësisht të mbrohet shumica e nxënësve në klasë apo edhe në shkollë.

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

Shkolla fill. “ Jeta e re”Greme-Ferizaj

Opinionet e mësimitdhënësve

- Të krijohen kushte për punë që nënkupton; kabinetet, sallat, mjetet mësimore dhe hapësirat e mjaftueshme shkollore.
- Të mbahen trajnimeve të ndryshme e sidomos ato lëndore, jo trajnime njëditore.
- Të përgatitën më mirë tekstet mësimore, është opinion më i theksuar.

Opinionet e nxënësve

- Të pajisen shkollat me kabine.
 - Të krijohet siguri më e madhe për nxënës në shkolla.
 - Të sigurohen mjete mësimore.
- Të sigurohet hapësirë e mjaftueshme shkollore.

Opinionet e drejtorit

- Janë trajnuar disa mësimitdhënës sa për tu certifikuar.

SHMM “Elena Gjika” Ferizaj

Opinionet e mësimitdhënësve

- Shumicës së trajnerëve u mungon përvoja e mësimitdhënies.
 - Të mbahen trajnime lëndore dhe për përdorimin e teksteve mësimore.
 - Të mbahen trajnime të mësimitdhënësve për vlerësim.
- Të mbahen trajnime për MKLSH.
Të mos trajnohen të njëjtit mësimitdhënës.

Opinionet e nxënësve

- Të zvogëlohet numri i nxënësve në klasa.
- Të sigurohen tekste mësimore.
- Shumë mësimitdhënës mbajnë teste vetëm për të thënë.
- Testet formulohen dobët nga shumica e mësimitdhënësve.
- Të informohemi më mirë për vlerësim të jashtëm.

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

- Nuk kryhen sa dhe si duhet praktikat profesionale.
- Mungon vlerësimi real nga mësuesit.
- Nuk aplikohen metodat e reja të mësimdhënies.
- Ti aktivizoni inspektorët për ti monitoruar mësuesit, në mënyrë që të shihni ku e kemi arsimin në këtë shekull.
 - Profesorët të mos i pranojnë intervenimet.
 - Celularët ti çkyqin mësuesit gjatë orës mësimore.

Opinionet e drejtorit

- Të mbahen trajnime të vazhdueshme.

Shkolla fill. "Ahmet Hoxha" Ferizaj

Opinionet e mësuesve

- Shumicës së trajnerëve u mungon përvoja e mësimdhënies trajnime lëndore dhe për tekste mësimore të mos trajnohen të njëjtit mësues.

Opinionet e nxënësve

- Vlerësimet me teste janë të tepruara
- Shpesh ka ndodhur që brenda dite të mbahen nga dy-tre teste
- Mësuesit e moshuar e kanë humbur durimin
- Ka mësues të cilët ende vlerësojnë në mënyrë klasike, duke nxjerr nxënës të tabela.
 - Disa mësues e kalojnë kohën në orë mësimore, duke biseduar për tema jashtëmësimore.
- Në aktivitete, angazhohen të njëjtit nxënës
- Të hartohen teste me alternativa tjera.

Gjimnazi "Gjon Buzuku" Prizren

Opinionet e mësuesve

- të mbahen trajnime të vazhdueshme trajnime nga lëndë profesionale trajnime me trajnerë profesional

Opinionet e nxënësve

- Të mbahen trajnime të mësimdhënësve me programe që kanë aktivitete shkolla e mesme të bëhet e obligueshme ky pyetësor, është i vetmi që na ka dhënë mundësi ti shprehim mendimet tona të bëhen më shpesh këso hulumtime shumë gjera kanë dalë nga kontrolli (ka korrupsion, jo barazi dhe mungesë të mjeteve) disa mësimdhënës edhe pse janë të diplomuar, nuk janë të përgatitur për mësimdhënie profesorët të mos i maltretojnë nxënësit në lëndët që su shkojnë profesorët që nuk angazhohen, pse vijnë në orë të mësimi disa profesorë po na detyrojnë ti mësojmë mësimet përmendësh, e jo ato me rëndësi njohëse të kultivohet më shumë toleranca e mësimdhënësve ka mësimdhënës që vetëm formalisht vijnë në orë mësimore të aktivizohen të gjithë nxënësit e jo vetëm disa stop kurseve me nxënës që vijnë në shkollë

Opinionet e drejtorit

- Të jenë të gjithë mësimdhënësit e trajnuar

SHMM “Luciano Matrioni” Prizren

Opinionet e mësimdhënësve

- Na mungon organizimi i debateve për shkëmbim përvojash me kolegë
- Trajnime të mbahen nga trajnerë që kanë përvojë në mësimdhënie
- Të aplikohet ligji për përgjegjësinë e nxënësve në shkollë
- Trajnime të mbahen sidomos me ata mësimdhënës që nuk kanë mbajtur lëndë pedagogjike.
 - Të mbahen trajnime për lëndë përkatëse
 - Trajnerët të jenë të lëndëve përkatëse
 - Gjatë trajnimeve të mos bëhen formalizma

Opinionet e nxënësve

- Mësimdhënësit të vlerësojnë realisht e jo të diferencojnë nxënës
- Mësimdhënësit, gjatë vlerësimit të mos hakmerren për sjelljet tona
- Vlerësimet të bëhen edhe me gojë, e jo vetëm me teste
- Të eliminohen intervenimet për vlerësimin e nxënësve
- Mësimdhënësit e kanë ndryshuar qëndrimin në mësimdhënie por në vlerësim jo
 - Mësimi praktik të zhvillohet gjatë gjithë vitit
 - Në shumicën e lëndëve mësimdhënësit japin shënime edhe për ato që kanë tekste
 - Vlerësimi i njohurive kryhet shumë formalisht
 - Tekstet mësimore të jenë sa më të kapshme
 - Plan-programet të thjeshtohen (të mos ketë ngarkesa)
 - Vlerësimet të mos bëhen në bazë të raporteve njerëzore
 - Të ndryshohen metodologjitë e lëndëve shoqërore nga ato shkencore
 - Të përfaqësohemi në të gjitha takimet ku ka interes për shkollën dhe të informohemi për të gjitha çështjet
 - Mungesa e teksteve shkakton shumë pengesa për metodologji të reja të procesit mësimor
 - Të hartohen tekste të kombinuara, të shkurta dhe të mbështetura në përmbajtje dhe shkathtësi

Opinionet e drejtorit

- Trajnimet të mos mbahen gjatë orarit mësimor

Shkolla fill. “Naim Frashëri” Malishevë

Opinionet e mësimdhënësve

- Të mbahen trajnime për çdo lëndë.
- Të mbahen trajnime në fusha të ndryshme.
- Të mbahen trajnime për udhëheqje arsimore (menaxhim të klasës).

Opinionet e nxënësve

- Mësimdhënësit ti sqarojnë gjerat më shumë.

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS

- Vlerësimi i njohurive të nxënësve është nën çdo nivel
- Të mbahen teste më shpesh
- Mësimdhënësit, po na qesin te tabela kur po na vlerësojnë
- Arsimitarët duet ta përmirësojnë kodin e sjelljes (të na kursejnë nga fjalët fyese)
 - Arsimitarët ta respektojnë orarin e mësimit dhe të mos mungojnë, sepse po na duhet ndihma e tyre më shumë se kurrë.
 - Mësimdhënësit janë shumica në nivel të duhur por kanë mundësi edhe më shumë për angazhim.
 - Mësimdhënësit tu shmangen metodave të vjetra të mësimit
 - Propozoj që mësimdhënësit të mos na diktojnë prej librit në të kundërtën nuk do ti blejmë librat
 - Mësimdhënësit ti angazhojnë edhe nxënësit e tjerë e jo vetëm disa.

Shkolla fill. “7 Shtatori” Vitomiricë-Pejë -Komuniteti Boshnjak

Opinionet e mësimdhënësve

Në pjesën e hulumtimit të opinionëve, janë nxjerrur opinionet e shprehura më shpesh të të gjithë respondentëve.

- Të mbahen trajnime me MKLSH.
Të mbahen rajnime urgjente për vlerësim
Të trajnohen të gjithë mësimdhënësit.

Opinionet e nxënësve

- Mësimdhënësit të heqin dorë nga vlerësimet me gojë
- Të gjithë mësimdhënësit duet të kalojnë nëpër trajnime
- Mësimdhënësit të na kursejnë nga fjalët fyese
- Mendojmë që disa mësimdhënësit edhe pse janë të diplomuar duhet të përgatiten profesionalisht.

Shkolla fill."Fan Noli" Dobrushë-Istog

Opinionet e mësimeve

- Të mbëhen trajnime të vazhdueshme
- Të mbahen trajnime me MKLSH
- Të harmonizohen tekstet me plan-programet mësimore
- Të mbahen trajnime me prindër
-

Opinionet e nxënësve

- Të krijohet përgjegjësia e nxënësve ndaj shkollës
- Testet të formulohen me pyetje më të qarta
- Tekstet shkollore të jenë më të përshtatshme
- Mësimeve të angazhohen në punën me nxënës.

PËRFUNDIME DHE KONKLuzionET

Konkluzione

1. Në shkollat tona i kushtohet rëndësi përgatitjes së nxënësve me njohuri njohëse dhe përshkruese e fare pak me ato hulumtuese.
2. Mësimdhënësit nuk kanë njohuri të mjaftueshme për tipet e ndryshme të vlerësimeve siç janë: përmbledhës, i bazuar në kriter, vetëvlerësues, diagnostifikues, ibrendshëm, i jashtëm, i përditshëm, paraprak, ivazhdueshëm, përfundimtar, objektiv, në proces, produkt, i bazuar në normë, ese dhe në bazë të Taksonomisë së Blumit. Vlenë të thekësohet se gjatë këtij hulumtimi, është konstatuar se mësimdhënësit nuk janë të informuar për kritere të vetëvlerësimit, sidomos të vlerësimit të **vehtes**.
3. Hartimi i testeve kryesisht bëhet me pyetje ku nxënësi duhet të plotësojë vendin e lënë të zbrazët, të kombinuar dhe me alternativa, por shumë pak i kushtohet rëndësi objektivave të niveleve të Taksonomisë së Blumit edhe pse sot ka mendimtarë të ndryshëm që mendojnë se më e përsosur është arritja e njohurive *spirale*, por që ne ende nuk kemi arritur tek një praktikë e tillë.
4. Trajnerët të jenë të përgjegjshëm dhe të marrin programet trajnuese me seriozitet e mos të kalojnë detyra e tyre në rutinë.
5. Shumë mësimdhënës kanë ndjekur trajnime të ndryshme vetëm sa për tu certifikuar sepse nuk i zbatojnë metodologjitë e reja, edhe pse ata arsyetohen se nuk kanë kushte por megjithatë shumica prej tyre mund të aplikohen edhe në këto rrethana duke iu përshtatur situatave të ndryshme.
6. Të krijohen mekanizma monitorimi dhe vlerësimi nga MASHT për mësimdhënës të certifikuar nga programe të ndryshme trajnimi.
7. Të krijohen mekanizma monitorimi nga MASHT për vlerësimin e organizatave dhe agjencioneve trajnues.
8. Të krijohen mekanizma verifikimi për kapacitetet ekzistuese trajnuese në nivelet lokale, me qëllim të shfrytëzimit të ngritjes profesionale të mësimdhënësve dhe të mësimdhënies dhe të nxënies në përgjithësi.
9. Metodologjitë e reja të mësimdhënies janë keqpërdorë apo keqkuptuar duke i lënë që nxënësit vetë të lexojnë dhe të reflektojnë pa ndihmën e mësimdhënësve. Opinione të nxënësve tregojnë se disa mësimdhënësit shkojnë në orët mësimore fare të papërgatitur

10. Udhëheqësit e shkollave nuk tregojnë interesim të mjaftueshëm për punën e mësimit dhe nxënësve gjatë procesit mësimor.

Përfundime

Trajnimi i mësimit për procesin mësimor është një çështje mjaftë e rëndësishme dhe me prioritet për zhvillimin e suksesshëm të arsimit në Kosovë. Zhvillimi i një sistemi modern të arsimit varet nga aftësimi i vazhdueshëm profesional i mësimit. Mësimit, demonstroi të nxënësve permanent në qoftë se institucionet arsimore përkrahin aftësimin e vazhdueshëm profesional si një përkushtim për përmirësimin e procesit të mësimit dhe mësimnxënies. Duke i pasur parasysh ndryshimet në arsimin parauniversitar, paraqitet nevoja që të përgatiten programe për trajnimin e mësimit. Institucionet tona dhe e gjithë shoqëria duhet të përkrahin këtë proces duke krijuar sisteme dhe programe që adresojnë nevojat e mësimit për trajnime të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me ngritjen e cilësisë në arsim. Institucionet e zhvillimit të arsimit duhet të përgatisin plan-programe për të gjitha nevojat që kanë të bëjnë me përsosjen profesionale të edukatorëve dhe mësimit. Andaj aftësimi profesional i mësimit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm në mënyrë që mësimit të jenë pjesë e pandashme e mësimit dhe mësimnxënies bashkëkohore.

Në këtë kontekst hipotezën që e kemi parashtruar që në fillim përputhet me rezultatet e këtij hulumtimi.

LITERATURA

1. Musai, Bardhyl, Metodologji e Mësimdhënies, Tiranë, 2003
2. Standardet dhe Manuali për Certifikim të Programit të MKLSH, KEC
3. Zeneli, Isuf, Bazat e Standardizimit dhe Vlerësimit në Arsim, Prishtinë, 2002